

Universiteti POLIS ka kënaqësinë të shpall të hapur një pozicion pune për një anëtar të personelit në **Njësinë Juridike**.

Nëse mendoni se jeni i përshtatshëm dhe me përvojë për këtë vend të hapur pune, ju inkurajojmë të lexoni specifikimet e punës si më poshtë.

Kërkesat/Kualifikimet e përgjithshme

- Diplomë universitare në Drejtësi
- Përvojë pune në fushën e juridike
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim.
- Njohja e sektorit të arsimit të lartë përbën avantazh

Lloji i pozicionit të punës

Me kohë të plotë

Përshkrimi i pozicionit të punës

- mbulon të gjitha aspektet ligjore të veprimtarisë së universitetit;
- formulon kontratat e stafit, studentëve, etj., dhe siguron që kontratat kanë bazë ligjore;
- mban marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe private homologe;
- njeh legjislacionin në fuqi në lidhje me arsimin e lartë në RSH dhe kryesisht ate privat;
- shërben si këshilltar ligjor për organet drejtuese të universitetit për çdo çështje për të cilën është i nevojshëm opinion ligjor;
- kontrollon, sistemon dhe arkivon të gjithë dokumentacionin ligjor që ka të bëjë me aktivitetin e universitetit;
- përfaqëson universitetin në raste konfliktesh dhe për gatit kërkesë-padi dhe çdo akt tjetër të nevojshëm për çështjen në fjalë;
- si dhe çdo detyrë tjetër që kërkohet nga universiteti dhe që mund të përfshihet në natyrën e profesionit të juristit.

Procedura e Aplikimit

Për të aplikuar për këtë pozicion dërgoni si më poshtë vijon:

- Letër interesi
- Curriculum Vitae

Aplikimet mund të dërgohen në adresën e mëposhtme

rektorati@universitetipolis.edu.al

Aplikimi është i hapur deri më datën **10.09.2017, ora 17:00**.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistë.

Ju faleminderit!